



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

REPUBLICA E KOSOVES REPUBLIKA E KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. 03-02/DPK
Br. Prot. 01-388/16
Prot No
Data 01-02-2016
Datum
Date

02

DATË/A:	29.01.2015
REFERENC-Ë:	AKK-DPK-03-02/50/16
PËR/ZATO:	z. Adriatik Stavileci , Zëdhënës i Doganës së Kosovës
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Hasan Preteni, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me ofrimin e këshillimit profesional për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik

I nderuari z. Stavileci,

Në mbështetje të nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.12) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe nenit 19 (paragrafi 1 pika 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, lidhur me kërkesën tuaj, për shqyrtimin e gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit në rastin e themelimit të një kompanie private e cila do të merret me hulumtim dhe konsulencë. Veprimtari kryesore e kompanisë do të jetë marketingu apo më saktësisht brand auditim. Në pajtim me mandatin që kemi dhe duke u bazuar në Ligjet bazë të Agjencisë, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, Nr.04/L-051, në nenin 4 të këtij Ligji (në tekstin e mëtejme Ligji për PKI), janë të përcaktuar kategoria e zyrtarëve të lartë publik, të cilët i nënshtrohen zbatimit të dispozitave të këtij Ligji.

Ndërsa, funksioni i juaj i zëdhënësit të Doganës së Kosovës nuk hynë në mesin e kategorisë së zyrtarëve të lartë publik. Mirëpo jeni i obliguar të respektoni aktet ligjore dhe nënligjore të cilat e rregullojnë çështjet e konfliktit të interesit në institucionin tuaj.

Kodi i Mirësjelljes i Doganës së Kosovës Nr.244, konkretisht në nenin 17 parasheh Konfliktin e Interesit, në të cilin shprehimisht thuhet:

“Konflikti i Interesit është situatë në të cilin zyrtari doganor ka një interes personal të tillë që ndikon ose mund të ndikoj në paanshmërinë ose objektivitetin e kryerjes së detyrës zyrtare. Në këtë rast të një konflikti të interesave personale dhe të përgjithshme, zyrtari doganor duhet të veprojë në pajtim me interesin e përgjithshëm”

“Interesat personale të zyrtarit doganor përfshijnë çdo përparësi për veten, familjen, të afërmit deri në shkallën e dytë për personat ose organizatat, me të cilat zyrtari ka ose ka pasur marrëdhënie biznesi ose lidhje politike, çdo lloj detyrimi financiar ose civil të zyrtarit”.

Rrjedhimisht, Ligji për PKI, në nenin (16 paragrafi 1,2,3), ka përcaktuar kufizimet e zyrtarit të lartë në ushtrimin e funksioneve tjera krahas ushtrimit të funksionit publik në të cilin shprehimisht thuhet:

1. *“Zyrtari i lartë publik nuk mund të jetë menaxhues ose anëtar i organeve menaxhuese në organizata fitimprurëse dhe jo fitimprurëse, përjashtuar subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet për shkak të funksionit.*

2. *Zyrtari i lartë publik nuk mund të ushtrojë veprimtari private, si; avokatisë, noterisë, ekspert të licencuar, konsulent, agjent apo përfaqësues të organizatave të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni.*

3. *“Zyrtari i lartë publik nuk mund të ushtrojë në mënyrë aktive të drejtën e pronësisë ose pjesë të pronësisë në një ndërmarrje, pavarësisht nga fusha e veprimtarisë së saj”.*

Po ashtu nenin 14 i Ligjit për PKI ka përcaktuar transferimin e të drejtave në drejtimin e ndërmarrjes në të cilin zyrtari i lartë me marrjen e funksionit të zyrtarit të lartë publik është i obliguar të bartë menaxhimin e ndërmarrjes të ndonjë personi besuar.

Agjencia kundër Korrupsionit ju falënderon për bashkëpunimin dhe ju inkurajon që të vazhdoni këtë bashkëpunim edhe në të ardhmen.

Me respekt!

